

Shtojca 1 e

Njoftimit për apel të ndërmjetëm në emër të Hysni GUCATIT (“Apeluesi”)

Publik

Archbold

Gjykatat Penale Ndërkombëtare
Praktikat,
Procedurat dhe Provat

AUTORËT

KARIM A. A. KHAN QC

nga Linkoln's In, Barrister

Rodni Dikson /Rodney Dixon/ QC

Nga Inner Tempell, Barrister

REDAKTORI KËSHILLTAR

GJYKATËS I GJYKATËS SË APELIT, ADRIAN FULFORD

Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, dhe ish-Gjykatës i GJPN-së

NDIHMËS REDAKTOR PËR BOTIMIN E PESTË

AIDAN ELLIS, AVOKAT

URDHRAT DHE MANDATET

§6-266

Në çështjen e Abdullah Bandës, Dhoma e Procedurës Paraprake fillimisht lëshoi një fletëthirrje për paraqitje në Gjykatëmë 27 gusht 2009 (*Prokurori k. Bandës*, Fletëthirrje për Apelim për Abdullah Bandën Abakaer Nourain, ICC-02/05-03/09-20, 27 gusht 2009). Pas konfirmimit të akuzave, Dhoma e Apelit konfirmoi vlefshmërinë e fletëthirrjes dhe urdhëroi Administratorin që t'i transmetonte Qeverisë së Sudanit kërkesën për bashkëpunim që të ndërmerreshin të gjithë hapat e nevojshëm për të mundësuar praninë e z. Banda në gjykim (*Prokurori k. Bandës*, Vendim në lidhje me hapat e mëtejshëm të Gjykimit, ICC-02/05-03/09-590, 14 korrik 2014). Duke u bazuar në mosdorëzimin e kërkesës për bashkëpunim, dhe përkundër respektimit të kushteve të fletëthirrjes nga i akuzuari, shumica e Dhomës së Apelit, me Gjykatës Chile Eboe-Osuji mospajtues, lëshoi fletarrestimin kundër tij (*Prokurori k. Bandës*, Fletarrestim për Abdullah Banda Abkaer Nourain, ICC-02/05-03/09-606, 11 shtator 2014). Dhoma konstatoi se "pa marrë parasysh a dëshiron z. Banda të jetë i pranishëm në gjykim apo jo, nuk ka garanci se në rrethanat aktuale ai do të jetë në pozitë objektive që të paraqitet vullnetarisht." (më lart, para. 21). Pas apelimit, Dhoma e Apelit, e ngarkuar me çështjen se a duhej t'i kishte dhënë Dhoma Gjyqësore z. Banda më shumë mundësi për të paraqitur parashtrime në lidhje me përshtatshmërinë e zëvendësimit të fletëthirrjes me fletarrestim, konstatoi se Dhoma Gjyqësore e kishte ushtruar si duhej kompetencën e saj për interpretimin e ligjit dhe të fakteve në dispozicion. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit e hodhi poshtë apelimin e z. Banda për shkaqe procedurale pa konsideruar përshtatshmërinë e vendimit të Dhomës (*Prokurori k. Bandës*, Aktgjykim për Apelimin e Abdullah Bandës kundër lëshimit të fletarrestimit nga Dhoma Gjyqësore IV, ICC-02/05-03/09-632, 3 mars 2015, paragrafët 27-35).

Pas lëshimit të fletarrestimit ose fletëthirrjes, Prokurori mund të vazhdojë të mbledhë prova në përgatitje të dokumentit që përmban akuzat (Shih GJPN rregulla 52 e Rregullores së Gjykatës). Brenda afatit të caktuar nga Dhoma e Procedurës Paraprake, Prokurori duhet të paraqesë dokumentin që përmban akuzat për mbajtjen e seancës së konfirmimit në pajtim me nenin 61.

Për mundësinë që Dhomat Gjyqësore të thërrasin dëshmitarë, shih Kreun 4: Kompetencat e Gjykatës; për Dokumentet e Akuzës dhe Seancat e Konfirmimit të GJPN-së, shih Kreun 7: Procedura Paraprake dhe e Konfirmimit.

(3) Procedurat e tribunaleve ad hoc dhe gjykatave speciale

Në tribunalët ad hoc dhe gjykatat speciale, lëshimi i fletarrestimeve mund të bëhet vetëm pas konfirmimit të aktakuzave të përgatitura nga prokuroria bazuar në hetimet e saj. Nga kjo presupozohet se ekzistojnë prova prima facie kundër të akuzuarit (shih më lart).

Standardi i rishikimit për lëshimin e fletarrestimeve

TPNJ/TPNR/MPNTP/GJSSL/TLS/DHSKZPS

Kur hetimet e bëjnë Prokurorin të besojë se ka prova prima facie, Prokurori përgatit aktakuzën ku përfshin

6-265

§6-266

HETIMET, AKUZAT DHE FLETARRESTIMET

Paraqitjen përmbledhëse e të shkurtër të fakteve dhe krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari (shih nenin 18(4) Statuti i TPNJ-së /Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; nenin 17(4) Statuti i TPNR-së/Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën; nenin 16(4) Statuti i MRNTP-së /Mekanizmi Përmblyës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë/; rregullën 47 (B) Rregullorja e GJSSL-së /Gjykata Speciale për Sierra Leonen; rregullën 68 Rregullorja e TSL-së /Tribunali Special për Libanin/; nenin 38(4) Ligji i DHSKZPS-së /Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar/). Gjykatësi kujdestar ose gjykatësi rishikues i caktuar për këtë çështje e rishikon aktakuzën. Nëse bindet se Prokurori e ka vërtetuar çështjen prima facie, gjykatësi i caktuar e konfirmon aktakuzën (shih nenin 19(1) Statuti i TPNJ-së; nenin 18(1) Statuti i TPNR-së; nenin 17(1) Statuti i MPNTP-së; nenin 18(1) Statuti i TSL-së; rregullën 7 Rregullorja e TPNJ/TPNR/GJSSL-së; rregullën 68 Rregullorja e TSL-së; nenin 39(2) Ligji për DHSKZPS-në). Vetëm atëherë gjykatësi kujdestar ose gjykatësi rishikues mund të lëshojë fletarrestim (shih nenin 19(2) Statuti i TPNJ-së; nenin 18(2) Statuti i TPNR-së; nenin 17(2) Statuti i MPNTP-së; nenin 18(2) Statuti i TSL-së; nenin 39(3) Ligji për DHSKZPS-në).

Për të vërtetuar çështjen prima facie, Prokurori duhet të vërtetojë se ka prova të mjaftueshme për të ngritur bazë të arsyeshme që të besohet se i dyshuari ka kryer krime që janë nën juridiksionin e Tribunalit (rregulla 47(B) Rregulloret e TPNJ/TPNR-së; rregulla 48(B) Rregullorja e MPNTP-së; rregulla 68(B) Rregullorja e TSL-së). Në kontekst të ndryshimit të aktakuzës në TPNJ, çështja prima facie është përkufizuar si “çështje e besueshme e cila, nëse nuk kundërshtohet nga mbrojtja, do të ishte e mjaftueshme për ta shpallur të akuzuarin fajtor për akuzat”. (*Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit*, Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për leje për ndryshimin e Aktakuzës së ndryshuar, 16 dhjetor 2005, f 3; *Prokurori k. Sheshelit*, Vendim mbi mocionin e Prokurorisë për të ndryshuar Aktakuzat, 8 qershor 2006, para. 13).

Standardi për rishikim para GJSSL-së ndryshon nga ai i TPNJ-së, TPNR-së dhe TSL-së. Në përputhje me rregullën 47(E) të Rregullores së GJSSL-së, gjykatësi i caktuar miraton aktakuzën nëse bindet që:

- i. aktakuza e akuzon të dyshuarin për krim ose krime brenda juridiksionit të Gjykatës Speciale; dhe
- ii. pretendimet në përmbledhjen e çështjes të Prokurorit, nëse vërtetohen, do të arrinin nivelin e krimit ose të krimeve siç janë saktësuar në aktakuzë.

Para DHSKZPS-së, Prokurori i Specializuar duhet të përgatis aktakuzat duke u bazuar në dyshim të bazuar mirë se një person është përgjegjës penalisht për një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomës së Specializuar (neni 38(4) Ligji për DHSKZPS-në).

Në përputhje me rregullën 79 të Rregullores së TSL-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë fletarrestim pas kërkesës nga Prokurori (i) për të siguruar paraqitjen e personit kurdo që kërkohet; (ii) për të siguruar që personi nuk do ta pengojë apo rrezikojë procesin gjyqësor, për shembull, duke paraqitur rrezik për viktimat ose dëshmitarët apo duke i frikësuar ata; ose (iii) për të parandaluar kryerjen e krimeve të llojit për të cilin akuzohet (rregulla 79(A) Rregullorja e TSL-së). Gjykatësi i Procedurës Paraprake që merr kërkesën e Prokurorit për të lëshuar fletarrestim, mund të vendosë që të lëshojë fletëthirrje për paraqitje në interes të drejtësisë, nëse bindet se fletëthirrja për paraqitje është më përshtatshme (rregulla 77(C) Rregullorja e TSL-së).

Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për hedhjen poshtë ose për miratimin e kërkesës së Prokurorit për fletarrestim në përgjithësi lëshohet ex parte, dhe rrjedhimisht, nuk dihet se si e përcakton Gjykatësi i Procedurës Paraprake se a janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e një urdhri të tillë. Kur i dyshuari është në paraburgim të Tribunalit, Mbrojtja mund të parashtrojë mocione paraprake para Dhomës Gjyqësore për të kundërshtuar aktakuzën ose për të pretenduar parregullsi në

Aktakuzat

§6-131

II. AKTAKUZAT

Në të gjithë Tribunalët dhe gjykatatad hoc, me përjashtim të dukshëm të DHJGJK-së /Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias/, aktakuzat përgatiten nga prokuroria dhe konfirmohen nga gjykatësi i procedurës paraprake (gjykatësi kujdestar i caktuar për të shqyrtuar aktakuzën në çështjen e veçantë) pas përcaktimit se ka prova prima facie kundër të dyshuarit (neni 18 Statuti i TPNR-së; neni 17 Statuti i TPNJ-së; neni 16 Statuti i MPNTP-së; rregullorja 47 Rregulloret e TPNJ/TPNR/GJSSL-së; rregulla 48 Rregullorja e MPNTP-së; rregulla 68 Rregullorja e TSL-së; neni 39 Ligji për DHKZPS-në; shihni më shumë më lart). Në tribunalët ad hoc, përgatitja dhe shqyrtimi i aktakuzës është proces ex parte pa asnjë pjesëmarrje të mbrojtjes ose viktimave. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të nxjerrë fletarrestim ose fletëthirrje për paraqitje Vetëm pas konfirmimit të aktakuzës, pasi që i dyshuari të jetë në paraburgim nga Tribunali, Mbrojtja mund të parashtrojë mocione para Dhomës Gjyqësore për të kundërshtuar aktakuzën ose për të pretenduar parregullsi procedurale (rregulla 72 Rregulloret e TPNJ/TPNR/GJSSL-së; rregulla 79 e Rregullores së MPNTP-së; rregulla 90 e Rregullores së TSL-së).

Procedura për ngritjen e aktakuzave kundër të dyshuarve në GJPN është krejtësisht e ndryshme nga procedurat e përcaktuara në tribunalët ad hoc dhe dokumentacioni i aktakuzës i përgatitur nga Prokurori i GJPN-së (Dokumenti që Përmban Akuzat, ose DPA) dallon në masë të madhe nga aktakuzat para TPNJ-së, TPNJR-së, MRNTP-së, GJSSL-së dhe TSL-së. Veçanërisht, DPA-të përgatiten nga Prokurori i GJPN-së vetëm pas nxjerrjes së fletarrestimit ose fletëthirrjes për paraqitje nga Dhoma e Procedurës Paraprake në përputhje me nenin 58. Për hir të qartësisë dhe për të ndjekur kronologjinë procedurale të gjykatave dhe tribunaleve, kjo pjesë do të merret vetëm me procedurën e ngritjes së akuzave dhe dokumentet e akuzës që janë zhvilluar nga tribunalet ad hoc. Përgatitja dhe konfirmimi i akuzave në GJPN janë shtjelluar në Kreun 7.

A. Dispozitat ligjore dhe Rregulloret

(1) TPNJ/TPNR/MPNTP

Statuti i TPNJ-së, nenet 18, 19(1)

6-131

Hetimet dhe përgatitja e aktakuzës!

18.-1. Prokurori i inicion hetimet *ex-officio* ose në bazë të informacionit të siguruar nga çfarëdo burimi, veçanërisht nga qeveritë, organet e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare. Prokurori e vlerëson informacionin e marrë ose të siguruar dhe vendos se a ka prova të mjaftueshme për të proceduar.

2. [...]

3. [...]

4. Pas konstatimit se ekzistojnë prova *prima facie*, Prokurori përgatit aktakuzën që përmban një paraqitje përmbledhëse e të shkurtër të fakteve dhe të krimit ose krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari sipas Statutit. Aktakuza i transmetohet gjykatësit të Dhomës Gjyqësore.